



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4754/2-prot

URDHËR

Nr. 368 DATË 15/07/2019

“PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIT PËR MOSPËRMBUSHJEN E MASËS
ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE E TË MITURVE NË
KONFLIKT ME LIGJIN”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 20.03.2019, “Për procedurën që zbaton Shërbimi i Provës në rast të mospërmbushjes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të raportit për mospërmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin (sipas shtojcës), bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

RAPORT VLERËSIMI 'PËR MOSPËRMBUSHJE TË MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE E TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN'

I. Të dhëna të përgjithshme

Të dhëna për të miturin

Emri i të miturit	
Atësia	
Mbiemri	
Datëlindja	
Vendlindja	
Adresa e banimit	
Numër kontakti	

Të dhëna për përfaqësuesin ligjor

Emër	
Mbiemër	
Cilesia e përfaqesimit	
Numër kontakti	

II. Të dhëna për çështjen

Numri i dosjes në Shërbimin e Provës	
Numri dhe data e vendimit gjyqësor	
Numri dhe data e urdhrit për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale (kopje e marrëveshjes gjendet bashkëlidhur raportit)	

III. Koha, vendi dhe rrethanat e mospërmbushjes së detyrimeve

IV. Përshkrimi dhe analizimi i informacionit për të miturit

Përfshihen: Informacion mbi gjendjen e tij sociale, historinë personale, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, gjendjen financiare, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e konsideron të rëndësishëm

V. Përmbledhja

Përfshihen: Përmbledhje e gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize mbi shkakun e mospërbushjes së detyrimeve të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit.

VI. Analiza e qëllimshmërisë së mospërbushjes së detyrimeve

Përfshihen: Analiza nëse mospërbushja e këtyre detyrimeve është kryer me apo pa qëllim nga ana e të miturit

VII. Burimet e informacionit

Përfshihen: Burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin duke përfshirë personat e intervistuar dhe dokumentat e konsultuara.

Intervistë me të miturin Tjetër _____

VIII. Përfundimet dhe rekomandimet

Përfshihen: përfundimet dhe rekomandimet e Shërbimit të Provës për prokurorin në referim të V.K.M nr. 148, datë 20.03.2019 'Për procedurën që zbaton Shërbimi i Provës në rast të mospërbushjes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale' dalë në zbatim të nenit 71, 72 të ligjit nr. 37/2017. Shërbimi i provës mund të rekomandojë: a) zgjatjen e kohës së marrëveshjes, b) ndryshimin e llojit të masës së shmangies, c) revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale.

Punonjësi i Shërbimit të Provës (emri/mbiemri dhe nënshkrimi)

.....
Drejtuesi i zyrës vendore (emri/mbiemri dhe nënshkrimi)

.....
Vida e institucionit